

## XHAMIA "EL-AKSA" DHE DITA BOTËRORE E KUDSIT

Haxhi Shejkh Vullnet MERJA

### Me emrin e Allahut, të gjithmëshirshmit Mëshirplotit

Allahu i Madhëruar në Kur'anin e shenjtë thotë: "...kush madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij." (Sure "Haxh", ajeti 32)

Prej shenjave të fesë së Allahut të Madhëruar është edhe xhamia "El Aksa".

### PANORAMË RRETH XHAMISË EL-AKSA

Pas Qabes, xhamia "El-Aksa" është xhamia e dytë e ndërtuar në Tokë për adhurimin e Allahut. Ajo është prej vendeve të shenjta të myslimanëve. Ajo ka qenë kiblja e parë e tyre. Kjo xhami është brenda qytetit të vjetër të Kudsit (Jeruzalemit), i cili ndodhet afërsisht në qendër të Palestinës së pushtuar.

Qyteti i Kudsit është 750 metra mbi nivelin e detit Mesdhe dhe 1150 metra mbi nivelin e Detit të Vdekur. Ai rrethohet nga pesë male. Në të gjenden katër lugina. Qyteti është 52 km larg nga deti Mesdhe, 22 km nga Deti i Vdekur, 252 km nga Deti i Kuq, 88 km nga Omani, 388 km nga Bejruti dhe 290 km nga Damasku. Sipas statistikave të muajit dhjetor, 2007 qyteti i Kudsit numëronte 747600 banorë.

Qyteti është ndërtuar në mijëvjeçarin e katërt p.e.r. nga Kena'nët (emri i vjetër i popullsisë palestineze). Ai është zgjeruar dhe rindërtuar disa herë gjatë historisë, duke filluar në kohën e profetit Sulejman, në kohën e halifit të dytë, Umer ibn Hatab, në kohën e Mervan ibn Hakemit (viti 72 i hixhrit), në kohën e halifit të shtatë, Fatimij (viti 425 i hixhrit), në kohën e memalikëve (viti 651 i hixhrit), në kohën e sulltan Kanunijit (viti 1542 gregorian).

Kudsi përmendet edhe në Kur'anin e Shenjtë, në suren "Isra", ajeti 1: "**I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij (Muhammedin) natën nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jeruzalemit), rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t'i treguar atij disa nga mrekullitë Tona. Ai, me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë.**" Në këtë ajet përmendet një prej mrekullive madhështore për profetin Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), që është ngritja në qiell (Israja dhe Miraxhi) nga ky vend i shenjtë.

Xhamia "El-Aksa" është një ndër tri xhamitë, në të cilat shkohet për vizitë. Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "*Asnjë udhëtim nuk duhet të ndërmerret (për vizitë), përveçse në tri xhamitë: Xhamia e Shenjtë (Qabja), Xhamia e Profetit në Medinen e Ndritur dhe xhamia "El-Aksa".*"

Xhamia "El-Aksa" është ndërtuar dyzet vjet pas Qabes, siç vërtetësohet nga hadithi i Ebu Dherit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), kur ai e pyeti Profetin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!): "Cila është xhamia e parë e ndërtuar mbi tokë?" Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) iu përgjigj: "Xhamia e Shenjtë (Qabja)."

Ebu Dheri e pyeti pastaj: "Pastaj cila xhami?"

Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) u përgjigj: "Xhamia "El-Aksa"."

Ebu Dheri e pyeti përsëri: "Sa vjet ka midis të dyjave?"

Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) u përgjigj: "Dyzet vjet."

Për shkak të periudhës së shkurtër midis ndërtimit të këtyre dy xhamive, disa dijetarë kanë mendimin që profeti Ibrahim i ka ndërtuar të dyja. Historianët kanë përmendur që profeti Jakub (Paqja qoftë mbi të!) e ndërtoi xhaminë afër gurit, nga ku profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) u ngrit në qiell.

Sipërfaqja e xhamisë "El-Aksa" është 144 mijë metra katrorë (sa një e gjashta e hapësirës së qytetit të vjetër të Kudsit). Përmasat e xhamisë janë: muri nga ana e jugut është 281 metra; muri nga ana e veriut, 310 metra; muri nga ana e lindjes, 462 metra; muri nga ana e perëndimit, 491 metra. Kjo Xhami ka katër minare, që ndodhen në anën jugperëndimore, perëndimore, veriperëndimore dhe veriore. Xhamia ka katërmbëdhjetë kupola: kupola e Sulejmanit, kupola e Hidrit, kupola e Miraxhit, kupola e Musait, kupola e shpirtrave etj. Ajo ka pesëmbëdhjetë porta, pesë prej të cilave janë të mbyllura.

Kuptimi i fjalës "El-Aksa" është "i largët". Thuhet se e ka marrë këtë emër për shkak të largësisë së saj me Xhaminë e Shenjtë në Mekë - Qaben. Para përmendjes së saj në Kur'an, ajo quhej "Bejtul Makdis".

Në këtë vend kanë jetuar shumica e të dërguarve dhe profetëve, si profeti Daud, profeti Sulejman, profeti Ja'kub, profeti Musa, profeti Isa dhe babai i monoteizmit, profeti Ibrahim (Paqja e Allahut qoftë mbi ta!). Gjithashtu, në këtë vend ka shërbyer edhe hazreti Merjemja (Maria), nëna e profetit Isa (Paqja e Allahut qoftë mbi ta!). Historia e saj përmendet në Kur'anin e Shenjtë në suren "Al Imran" dhe në suren "Merjem". Pra, Bejtul Makdes është vatra e të gjitha feve qiellore dhe nderohet e respektohet nga të gjithë besimtarët. Të gjithë besimtarët janë të lirë ta vizitojnë këtë vend të shenjtë.

## **ALLAHU E KA PËRSHKRUAR XHAMINË “EL AKSA” NË KUR’AN SI TOKË E BEKUAR**

Në Kur’an thuhet: **“I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij (Muhamedin) natën nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jeruzalemit), rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t’i treguar atij disa nga mrekullitë Tona. Ai, me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë.”** (Sure “Isra”, ajeti 1)

Përderisa Allahu thotë në Kur’an se ky vend është i bekuar, atëherë edhe njerëzit në këtë vend duhet të jetojnë në paqe e siguri. Namazi në të është më i vlefshëm se në xhamitë e tjera, përveç Qabes dhe Xhamisë së Profetit. Në hadithe thuhet se vlera e një namazi në këtë Xhami është sa një mijë namaze në xhamitë e tjera a sa 500 namaze në xhamitë e tjera, a sa 250 namaze në xhamitë e tjera.

**Xhamia “El-Aksa” është Kiblja e parë e myslimanëve**, ashtu siç është kumtuar nga El-Bara: *“I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është falur në drejtim të el-Bejt el-Makdisit për gjashtëmbëdhjetë ose shtatëmbëdhjetë muaj.”*

Qyteti i Kudsit dhe xhamia “El-Aksa” janë në zemrën e çdo myslimani dhe myslimaneje. Ato i pëmend edhe Kur’ani i Shenjtë:

Allahu i Madhëruar thotë: **“O populli im! Hyni në Tokën e shenjtë që Allahu e ka caktuar për ju dhe mos u ktheni prapa, sepse atëherë do të ktheheni të humbur!”** (Sure “El-Maide”, ajeti 21)

Dhe: **Ndërsa popullit të përndjekur Ne i dhamë në zotërim viset lindore dhe perëndimore të tokës që kishim bekuar. Kështu u përmbush premtimi i bukur i Zotit tënd ndaj izraelitëve, për shkak të durimit që treguan. Ndërsa ndërtesat dhe kullat e Faraonit dhe të popullit të tij Ne i shkatërruam.** (Sure “A’raf”, ajeti 137)

Dhe: **“Ne e shpëtuan atë (Ibrahimin) dhe Lutin (dhe i çuam) në tokën, të cilën e kemi bekuar për njerëzit.”** (Sure “El-Enbija”, ajeti 71)

Dhe: **“Sulejmanit i dhamë erën e fortë, që të fryjë sipas urdhrit të tij, drejt tokës, të cilën Ne e kemi bekuar.”** (Sure “Enbija”, ajeti 81)

Dhe: **“Midis atyre dhe qyteteve që i kemi bekuar, Ne vendosëm vendbanime të dukshme buzë rrugës dhe e bëmë të lehtë udhëtimin (duke u thënë): “Udhëtoni të sigurt nëpër to natë e ditë!”** (Sure “Sebe”, ajeti 18)

Dhe: **“Në xhamitë, që Allahu ka urdhëruar të ngrihen e të përmendet aty emri i Tij, Atë e lavdërojnë në mëngjes dhe mbrëmje.”** (Sure “En-Nur”, ajeti 36)

Dhe: **“Kush është më fajtor sesa ai që pengon të përmendet në xhamitë e All’lilahun Emri i Tij dhe përpiqet për shkatërrimin e tyre? Ata nuk duhet të hyjnë në to, përveçse të frikësuar. Për ata, në këtë jetë ka poshtërim, kurse në Jetën Tjetër, dënim të madh.”** (Sure “El- Bekare”, ajeti 114)

## **DITA BOTËRORE E KUDSIT, DITA E BASHKIMIT TË MYSLIMANËVE**

Feja islame është fe e paqes. Ajo i kushton rëndësi të veçantë mbrojtjes së të shtypurve e të privuarve si dhe luftës kundër shtypjes. Në Islam nuk pranohet asnjë lloj shtypje dhe dhune ndaj të tjerëve dhe muslimanët e kanë për detyrë që me çdo mjet të qëndrojnë përballë shtypësve.

Profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë *“Në mëshirë e në dashuri besimtarët janë të njëjtë me trupin. Kur një organ i trupit ankohet prej tij edhe organet e tjera do të goditen me dhimbjen dhe lëndimin.”* (“Biharul Anvar”; vëll, 74, f. 234)

Dhe: *“Kush gdhahet dhe nuk interesohet për punët e myslimanëve, nuk është prej myslimanëve.”* (“Biharul Anvar”; vëll, 77, kreu 20, hadithi /120)

Dhe: *“Ai që dëgjon një mysliman, i cili thërret “o mysliman” dhe nuk i përgjigjet, nuk është mysliman.”* (“Biharul Anvar”; vëll, 75, kreu 59, hadithi /12)

Imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Bëhu përkrahës i të shtypurit dhe kundërshtues i shtypësit”.*

Nga thëniet e lartpërmendura të profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) kuptohet se solidarësia, ndihma dhe përkrahja e besimtarëve është detyrë islame.

Një prej popujve të privuar në këto ditë është populli palestinez, toka e të cilit për dhjetëra vite është e pushtuar nga cionistët izraelitë. Dhjetëra mijëra palestinezë janë martirizuar apo plagosur, miliona të tjerë kanë mbetur pa strehë mbi kokë dhe mijëra të tjerë ndodhen nëpër burgjet e regjimit sionist. Shumë e shumë të tjerë jetojnë jashtë tokave të tyre nëpër kampe si në Liban, Siri, Jordani, etj. Shtypja dhe vrasja e palestinezëve akoma nuk ka përfunduar dhe regjimi gjakatar sionist, kohë pas kohe kryen krime të ndryshme kundër këtij populli të përvuajtur, siç janë vrasjet, prishjet e shtëpive shkatërrimi i të mbjellave, etj. Meqenëse vëllezërit dhe motrat palestinezë çdo ditë përballen me krime të reja të regjimit cionist, të gjithë muslimanët e botës janë përgjegjës për këtë çështje.

Një prej sfidave të Palestinës së pushtuar dhe e popullit trim palestinez është gjendja e vështirë e Xhamisë "El-Aksa", kiblja e parë të muslimanëve dhe vendi i Israsë dhe i Miraxhit (i ngritjes në qiell) të Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Që nga viti 1976 kur cionistët izraelitë e pushtuan këtë vend të shenjtë, filluan prishjen dhe shkatërrimin gradual të kësaj xhamie. Ata pretendojnë se xhamia "El-Aksa" është ndërtuar mbi rrënojat e tempullit të Sulejmanit dhe pasi ta prishin këtë xhami, duan të ndërtojnë një tempull në vend të saj. Për këtë arsye, që nga viti 1967, xhamia "El-Aksa" vazhdimisht është përballur me agresione të ndryshme ku akti më i keq ishte zjarrvënja e kësaj xhamie nga një cionist ekstrem në vitin 1969. Nën themelet dhe përreth xhamisë "El-Aksa" janë bërë dhe bëhen gjermime të ndryshme nga cionistët izraelitë duke rrezikuar shembjen e kësaj xhamie.

Në shenjë solidariteti me popullin palestinez dhe në përpjekje për çlirimin e Kudsit nga kthetrat e pushtuesit cionist, në gusht të vitit 1979 themeluesi i Republikës Islamike të Iranit, imam Khomeini (paqja qoftë mbi të!) të premten (xhumanë) e fundit të muajit të bekuar të Ramazanit, siç është dita e sotme, e ka quajtur dita botërore e Kudsit.

Imam Khomeini (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: *“Unë kërkoj nga të gjithë muslimanët kudo që ndodhen që të premten (xhumanë) e fundit të muajit të bekuar të Ramazanit, e cila mund të jetë një prej ditëve të Kadrit, ta caktojnë si Ditën e Kudsit dhe gjatë një ceremonie të shprehin solidaritetin ndërkombëtar të muslimanëve në mbështetje të të drejtave legjitime të popullit palestinez”.*

Dita botërore e Kudsit mbahet edhe sot. Kjo ditë organizohet masivisht jo vetëm në Iran por edhe në shumë vende të tjera të botës në mbështetje të popullit të privuar e të pushtuar palestinez.

Sekretari i përgjithshëm i Xhihadit Islamik të Palestinës Ramadan Abdullah Shalah ka deklaruar: "Kudsi duhet të mbahet gjallë në kujtimet e ummetit islam dhe në brazat e ardhshëm. Caktimi i të premtes së fundit të muajit të bekuar të Ramazanit si Dita botërore e Kudsit nga Imam Khomeini (paqja qoftë mbi të!) është një mundësi për të mbajtur gjallë çështjen palestineze dhe për të reflektuar realitetin që po ndodh në këtë vend të shtypur e të pushtur.

Dita Botërore e Kudsit na kujton të gjithëve çështjen themelore të botës myslimane për të cilën të gjithë myslimanët duhet të interesohen për të dhe ajo është çështja e Palestinës. Në kohën kur imam Khomeini e caktoi Ditën Botërore të Kudsit, ai

ka qartësuar se çështja e Kudsit është një çështje e shenjtë për myslimanët dhe rëndësia e kësaj çështjeje po rritet në çdo vit.

Populli palestinez, pavarësisht kushteve shumë të vështira të jetës si dhe vuajtjeve e shpërnguljeve, vazhdon t'i qëndrojë besnik vendit dhe idealeve të tij dhe kurrë nuk dorëzohet përballë ambicieve të cionistëve. Çështja e Kudsit duhet të jetë çështje kryesore e botës islame dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të hiqet dorë prej saj.

Në mbyllje, do të donim të tërhiqim vëmendjen e myslimanëve se Mesxhidi "Aksa" nuk është ajo kubeja e artë, pamja e së cilës paraqitet shpesh nëpër mediat vizive. Ajo quhet Kubbetu-s Sakhra (Kubeja e Shkëmbit). Mesxhidi Aksa (xhamia "El-Aksa") është xhamia e vjetër, e cila ndodhet pranë saj. *(Kjo thënie është marrë nga shkrimi "Vlerat e Xhamisë Aksa në Islam dhe tek muslimanët", Alban Çuli, botuar në revistën "Këshilla", organ i Fondacionit të Kur'anit, botim i vitit 206-1427)*

Dëshiroj nga të gjithë myslimanët e ndërgjegjshëm e largpamës, besimtarët dhe besimtarët që të lusin Allahun në këto ditë të bekuara që kanë mbetur nga muaji i bekuar i Ramazait t'i luten Allahut që t'i ndihmojë myslimanët dhe t'i shpëtojnë ata prej kthetrave përçarjes, armiqësisë e pushtimit.

E lus Allahun e Lartësuar që t'ia shkurtojë duart pushtuesve prej tokave të myslimanëve. Allahu i Madhëruar na e mundësoftë vizitën e kibles së parë të myslimanëve, xhamisë El-Aksa. Gjithashtu, e lus Allahun që mbarë njerëzit të jetojnë në paqe, në dashuri dhe në harmoni.

Paqja, bekimet, mirësitë, mëshira dhe falja e Allahut qofshin na mbulofshin të gjithëve!